



Pranuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivered	04.03.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	1172/2022		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.157/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.157/2022 të datës 23.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Kamenicës, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.157/2022 të datës 23.02.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës së Kosovës me datë 21.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (e pranuar me datë 23.02.2022), kundër vendimit të Komisionit për Ankesa të Shërbimit Publik të Komunës së Kamenicës, me numër protokollit 3698 të datës 11.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:946/2022 e datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 11.02.2022 të Komisionit për Ankesa për Nëpunësit e Shërbimit Publikë; Ankesën e datës 04.02.2022 të ankuesit; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike i datës 01.02.2021; Kontratë për

Marrëdhënie pune e datës 01.01.2021; Vendimin e datës 30.11.2022 të Inspektoratit të Punës; Vërtetimin e datës 20.01.2022; Zarfën e datës 21.02.2022; Kërkesë për informatë e datës 02.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën A.nr.157/2022 të datës 23.02.2022, të parashtruar nga ankuesi. *sepse:*

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës është konstatuar se ankuesi sipas Kontratës për Marrëdhënie Pune me numër protokollit 417 të datës 01.01.2021, mbanë pozitën "Roje e Objektivit", në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport pranë Komunës së Kamenicës.

Ankuesi më datë 04.02.2022 ka parashtruar ankesë për Komisionin për Ankesa të Komunës së Kamenicës, kundër informatës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa Komisioni për Ankesa për Nëpunësit e Shërbimit Publik më datë 11.02.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 3698 me të cilin shpallet jokompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit, duke e konstatuar që kompetent për këtë çështje është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*" si dhe bazuar në paragrafin 6 të të njëjtit nen ku theksohet se: *"Nëpunës administrativ-technik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*, konstatoi se pozita "Roje e objektivit" hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë e shërbimit civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.157/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi

Sipas nenit 79 paragrafi 2 dhe nenit 82 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjisllacionin e punës, rrjedhimisht mbi këta bazë ligjore edhe ankuesi ka krijuar marrëdhënien e tij të punës sipas Kontratës së punës të datës 01.01.2021. Kështu që, në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.157/2022

Avdyl BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Arçita Haxhnikaj-DEMI



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Kamenicës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

